



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 799 Prot.

Tiranë, më 22 / 06 / 2020

V E N D I M

Nr. 65 , Datë 22 / 06 / 2020

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, mori në shqyrtim ankesën me nr.53 Regj., datë 12.06.2020, të Xh. I, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Shkodër, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “*moshës*”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Xh. I, në ankesën e depozituar pranë KMD shprehet se, në vitin 2012 ka bërë një kërkesë për rishqyrtimin e pensionit pranë DRSSH Shkodër.

DRSSH Shkodër nëpërmjet shkresës me nr.2133 prot., datë 10.09.2012 e ka informuar atë se dokumentacioni i paraqitur nga ana e tij është vlerësuar në raport me kërkesat e ligjit, duke cituar: “*Në bazë të nenit 29, pika 1 të ligjit nr.10 142, datë 15.05.2009 thuhet se: “Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të caktuara në përputhje me ligjin nr.8087, datë 13.03.1996 do të rillogariten. Neni 16 i këtij ligji ka percaktuar se “Pensioni*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

suplementar i pleqërisë llogaritet me 1% të pagës mesatare referuese mujore për çdo vit shërbimi, por jo më shumë së 50% e pensionit të pleqërisë që përfituesi gëzon në çastin e lindjes të së drejtës për pension suplementar”.

Ankuesi shprehet se, sipas përcaktimeve të ligjit referues, atij i takon deri në 50% e shumës së pensionit dhe se atij asnjëherë nuk i është dhënë kjo shumë. Ai pretendon se është diskriminuar nga ana e DRSSH Shkodër, pasi edhe pas kërkesave të herë pas herëshme nuk e ka përfituar shtesën prej 50% dhe nuk i është argumentuar nga ky Institucion arsyeja se përse ai nuk e përfiton shtesën në masën e 50% të pensionit të pleqërisë. Ai citon se ka përfituar një shtesë më të vogël e cila është e ndryshueshme çdo muaj. Shtesa e fundit e cituar nga subjekti ankues i referohet asaj të muajit Qershor 2020 në shumën 10.332 lekë ndërkohë që ai pretendon se kjo shtesë duhet të ishte në shumën 14.000 lekë, e njëjtë dhe e pandryshuar për çdo muaj.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e DRSSH Shkodër, si dhe shtesën e pensionit suplementar në masën 50%, bashkë me shtesat e munguara të muajve të kaluar, në përputhje me masën 50%.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje nga diskriminimi. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:

- Xh. I është vënë në dijeni të faktit të përfitimit të shumës së pensionit suplementar, të cilën ai konteston, që në vitin 2012.
- Bazuar në faktin që ai ka kërkuar shkresërisht pranë DRSSH Shkodër rishqyrtimin e pensionit të tij, si dhe bazuar në përgjigjen e DRSSH Shkodër drejtuar ankuesit nëpërmjet shkresës me nr.2133 prot., datë 10.09.2012, Xh.I është njohur që në këtë datë me qëndrimin zyrtar të këtij institucioni lidhur me përlllogaritjen e shtesës së pensionit suplementar të pretenduar prej tij.
- Në kontekst të sa mësipër, **ankuesi ka marrë dijeni për shumën e përlllogaritur të pensionit të tij suplementar nga DRSSH Shkodër** (për të cilin dhe pretendon diskriminimin), **të paktën që në muajin Shtator 2012. Ankesa pranë KMD-së është**

regjistruar në datën 12.06.2020, pra më vonë se rreth 8 vite nga marrja dijani e këtij fakti, si dhe nga ndodhja e diskriminimit të pretenduar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt”*, ankesa e z.Xhemal Isufi, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së Xh. I, për shkak se është jashtë afatit për shqyrtimin e ankesave, sipas parashikimit të dispozitave të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Moshë
Fusha: Shërbime